



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 26.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.07.2023, të parashtruar nga Grupi operatorëve Ekonomik **Agim Morina B.I.; Bujar Shabani B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fshatin Kralan“**, Nr. i prokurimit-632-22-5854-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-079-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Grupit Operatorëve Ekonomik **Agim Morina B.I.; Bujar Shabani B.I** e dt.14.07.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fshatin Kralan“**, Nr. i prokurimit- 632-22-5854-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-079-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 11.07.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 11.07.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

Arsyetim

Grupi Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; Bujar Shabani B.I me dt.14.07.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fshatin Kralan“, Nr. i prokurimit- 632-22-5854-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-079-521.

Me dt.18.07.2023, Grupi Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; Bujar Shabani B.I., janë tërhequr nga kërkesa për rishqyrtim dhe Autoriteti Kontraktues do të vazhdoj me procedurat e prokurimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

